



Moduli 3

Migraciones



Co-funded by
the European Union



Moduli 3

Migraciones



Co-funded by
the European Union

Table e Përmbajtjes

Kapitulli 1: Fakte të përgjithshme rreth migracionit	5
1.1 Fakte dhe shifra rreth migracionit	5
1.2 Shpjegime mbi përkufizimet	10
1.3 Migrimi është një e drejtë e njeriut	11
Kapitulli 2: Migracioni në BE: ligjet, institucionet dhe tendencat aktuale	13
2.1 Një politikë e përbashkët për migracionin në BE	13
2.2 Kontrollat kufitare në kufijtë e BE-së	16
2.3 Migrimi në Spanjë, Itali, Francë ose Shqipëri	20
• Franca • Italia • Spanja • Shqipëria	
2.4 Azili – Një Vështrim i përgjithshëm	24
Kapitulli 3: Vulnerabiliteti dhe migracioni: Grumbull diskriminimesh	30
3.1 Gratë	30
3.2 Personat LGBTQ+	32
3.3 Të miturit dhe të rinjtë	34
3.4 Çështjet e shëndetit fizik dhe mendor pas migrimit	35
Aktivitetet	38
Burimet	44





Hyrje

Çështja e migracionit është kthyer në një prioritet politik kyç në të gjithë Europën, si dhe në institucionet europiane. Institucionet europiane kanë vendosur rregullore për migrimet në Europë dhe do të vazhdojnë ta bëjnë këtë edhe në të ardhmen. Pritet që njerëzit të vazhdojnë të migrojnë në Europë, veçanërisht për shkak të konflikteve ose ndryshimeve klimatike. Migrimi është bërë gjithashtu një faktor kyç në zgjedhje parlamentare, duke përfshirë zgjedhjet e ardhshme europiane.

Në të gjithë Europën, idetë kundër emigracionit kanë fituar popullaritet gjatë zgjedhjeve, përfshirë këtu sukseset e fundit në Itali, Gjermani ose Holandë. Në disa vende, përfshirë Francën, ato madje u përfshinë kohët e fundit në legjislacion. Këto ide nxiten nga politikanët në shoqëri duke përdorur frikën e përbashkët shoqërore për humbjen e statusit ekonomik dhe/ose "identitetit" kombëtar.

Kështu, është e rëndësishme të kemi njohuri mbi temën e migracionit në Europë, në mënyrë që të analizohen siç duhet programet e kandidatëve dhe të formulohen propozimet përkatëse.

Pyetësori i vetëvlerësimit:

https://docs.google.com/forms/d/17IGYSKZy232ABNBA_qSdAD5tULL2I4lLeNgVe2vYn1l/viewform?edit_requested=true

Kapitulli 1

Fakte të përgjithshme mbi migracionin

1.1 Fakte dhe shifra rreth migracionit

Historikisht, të lëvizësh nga një vend në tjetrin ka qenë pjesë e njerëzimit pothuajse që nga fillimi i kohërave: që kur njerëzit e parë të lashtë që jetuan në tokë u përhapën nga Afrika në kontinentet e tjera, rreth 60 000 vjet më parë.

Në vitin 2022, numri i njerëzve që kanë qënë të detyruar të zhvendosen arriti një nivel të ri prej 108.4 milionë njerëz^[1]. Në vitin 2020, pothuajse gjysma e migrantëve globalë ishin gra (48.1%). Në nivel global, Europa dhe Azia kanë më shumë emigrantë ndërkombëtarë: në Europë, migrantët përfaqësojnë 11.6% të popullsisë^[2]. Megjithatë, 72% e refugjatëve jetojnë në një vend fqinj me vendin e tyre të origjinës sipas Këshillit të Refugjatëve^[3]: kështu, shumica e migrantëve në botë janë të mirëpritur nga vendet në zhvillim.

Ka shumë arsye që i shtyjnë njerëzit të migrojnë. Arsyet pse njerëzit largohen nga vendi i tyre zakonisht quhen "faktorë shtytës", ndërsa arsyet pse njerëzit tërhiqen nga një vend quhen "faktorë tërheqës".

Ne mund t'i ndajmë ato ne 3 kategori:

1. Faktorët socialë dhe politikë

Këto mund të nënkuptojnë :

1. Persekutimet: këto janë rreziqe ose dhunë me të cilën përballen njerëzit për shkak të përkatësisë etnike, fesë, racës, politikës, kulturës, gjinisë, orientimit seksual etj. Njerëzit mund të jenë viktimat të dhunës nga një shtet ose nga dikush tjetër, dhe ata nuk marrin mbrojtjen e Shtetit (policisë, ushtrisë) në vendin e tyre.
2. Situatat e konflikteve të armatosura: luftërat dhe konfliktet e armatosura e bëjnë të vështirë që njerëzit të përmbushin nevojat e tyre themelore. Njerëzit që nuk janë ushtarë mund të jenë gjithashtu në shënjestër nëpërmjet bombardimeve ose përfshirjes së detyruar në grupe të armatosura për shembull. Njerëzit që ikin nga vendi i tyre për shkak të këtyre faktorëve do të tërhiqen në vendet ku ata kanë më shumë gjasa të marrin mbrojtje, me politika më të hapura ndaj migrantëve.

2. 2. Faktorët demografikë dhe ekonomikë

Një popullsi në rritje, në tkurrje, në plakje ose e re ka një ndikim në rritjen ekonomike dhe punësimin. Aty ku standardet e punës së një vendi janë të varfra, papunësia është e lartë dhe/ose ekonomia e vendit është e pashëndetshme, njerëzit kanë më shumë gjasa të tërhiqen nga vende me kritere të tilla si paga më të larta, mundësi më të mira punësimi, një standard më i lartë jetese.

3. Migriacioni për shkak të mjedisit ose klimës

Njerëzit gjithmonë janë larguar nga fatkeqësitë natyrore (përmbytjet, uraganet, tërmetet) por këto fatkeqësi kanë qenë gjithnjë e më të pranishme vitet e fundit dhe pritet të shumohen për shkak të ndryshimeve klimatike. Emigrimet të shtyrë nga faktorët mjedisorë janë njerëz që detyrohen të lëvizin nga shtëpitë e tyre të zakonshme, për një kohë afatshkurtër ose afatgjatë.

Mund të jetë e vështirë të identifikohet shkaku specifik i migracionit për një individ të caktuar, sepse shkaqet mund të ndërthuren. Për shembull, ndryshimi i klimës mund të shkaktojë një situatë të keqe ekonomike që më vonë mund të shkaktojë një konflikt të armatosur, duke e detyruar një individ të largohet.

Shumë njerëz që largohen nga vendi i tyre i origjinës nuk zgjedhin ta bëjnë këtë, ata janë të detyruar për shkaqe socio-politike, ekonomike ose mjedisore. Megjithatë, rruga e migracionit është shpesh një rrugë shumë e rrezikshme. Sipas OJQ-së *Missing Migrants*, 63 279 migrantë kanë vdekur në botë që nga viti 2014. Rruga e Mesdheut Qëndror, që do të thotë rruga nga Afrika Veriore dhe Turqia për në Europën Jugore, është ajo më vdekjeprurëse: 29 087 njerëz kanë vdekur në Detin Mesdhe. që nga viti 2014[4]. Në rrugën e tyre të emigrimit, njerëzit në mërgim shpesh mund të ekspozohen ndaj rasteve të dhunës si trafikimi, dhuna seksuale, zhvatja, etj. Ky është veçanërisht rasti për gratë, njerëzit LGBTQ+, të rinjtë dhe njerëzit me shqetësime të shëndetit fizik ose mendor.

Në Europë, 5.3% e popullsisë totale të BE-së janë qytetarë jo të BE-së dhe 8.5% e të gjithë banorëve të BE-së kanë lindur jashtë BE-së. Në vitin 2022, 2.25 milionë njerëz emigruan në BE. Shumica e njerëzve qëndrojnë në Europë për shkak të familjes, punës ose për shkak se marrin statusin e refugjatit.

Për të kuptuar më mirë shifrat që lidhen me migracionin, duhet të merren parasysh edhe kthimet e të huajve në vendet e tyre.

Këto kthime mund të bëhen si rezultat i vendimeve të nxjerra nga vendet pritëse, për personat që nuk mund të qëndrojnë ligjërisht në vendin pritës. Në vitin 2022, 431,200 shtetas jo-anëtarë të BE-së u urdhëruan të largoheshin nga BE-ja. Për të krahasuar, në të njëjtin vit, 73 600 shtetas jashtë BE-së u kthyen me detyrim në një vend jashtë BE-së, kryesisht në Shqipëri, Gjeorgji, Turqi, Serbi dhe Moldavi[5]. 54% e kthimeve që u bënë pas një urdhri për t'u larguar nga BE-ja ishin vullnetare, që do të thotë se migrantët e zbatuan vullnetarisht vendimin[6]. 75% e kthimeve vullnetare kanë qenë kthime të asistuara, që do të thotë persona që kanë marrë ndihmë logjistike, financiare dhe/ose materiale të tjera.

Kthimet mund të bëhen edhe pavarësisht nga urdhri për t'u larguar, si rezultat i një vendimi individual të migrantit. Ky mund të jetë rasti për studentët e huaj që kthehen në vendet e tyre pasi kanë studiuar në BE, ose për pensionistët që vendosin të kthehen në vendin ku kanë lindur. Në Francë, për shembull, në vitin 2021, 246,000 emigrantë hynë në Francë dhe 45,000 u larguan. Në total, bilanci i migracionit ishte +201,000 njerëz[7].

Një tjetër fenomen që duhet marrë parasysh kur analizohen flukset migratore brenda dhe jashtë BE-së është ai i qytetarëve europianë që vendosin të largohen nga vendi i tyre për në një tjetër, brenda ose jashtë Bashkimit European. Të gjitha këto shifra janë marrë parasysh në bilancin e migracionit, që është diferenca midis numrit të njerëzve që kanë emigruar në BE dhe numrit të njerëzve që kanë emigruar nga BE. Në vitin 2021, ndërsa 3.7 milionë njerëz emigruan në BE, 2.5 milionë njerëz emigruan nga BE [8].

Migracioni në Europë përfaqësohet edhe nga vizat me qëndrim të shkurtër: në vitin 2022, në zonën Shengen, u kërkuar rreth 7.5 milionë viza për qëndrim të shkurtër, u lëshuan 5.9 milionë viza për qëndrim të shkurtër dhe 1.3 milionë u refuzuan [9]. Megjithatë, për të kuptuar këtë shifër, duhet të merren parasysh kombësitë me përqindjet më të refuzuara: në vitin 2022, shtetasve algjerianë iu refuzuan më shumë aplikimet për viza Shengen, me një përqindje totale të vizave të pa lëshuara prej 45,8%. Ata u pasuan nga aplikantët nga Maroku (28,2% përqindja e refuzimit), India (18% norma e refuzimit) dhe Turqia (15,2% norma e refuzimit). [10] Pra, ka pabarazi në përqindjet e refuzimit sipas vendit të origjinës së aplikantëve.

1. 2. Shpjegime mbi përkufizimet

Aktiviteti 1

Lidhni fjalën me përkufizimin e saj

Fjalët e mëposhtme do të përcaktohen:



i huaj | refugjat | migrant | azilkërkues | emigrant | imigrant | pa shtetësi | i mitur i pashoqëruar | trafikimi i qenieve njerëzore | **kontrabandë me njerëz** | person migrant në një situatë të parregullt | migracion i brendshëm | viza | leje qëndrimi | vend tranzitit | vendi i destinacionit | vendi i origjinës

Këto fjalë shpesh keqpërdoren në media dhe shoqëri. Për shembull, kush përkufizohet zakonisht si emigrant? A do të përkufizohet si emigrant një profesionist që lëviz nga një qytet në tjetrin? A do të përkufizohet si emigrant një person spanjoll që shpërngulet në SHBA? Shpesh, ky term përdoret për njerëzit në lëvizje që migrojnë nga vendet në zhvillim në vendet e pasura: kryesisht anëtarët e komuniteteve të dukshme të pakicave përkufizohen si migrantë. Për më tepër, termi "refugjat" shpesh përdoret gabimisht, në vend të fjalës "migrant". Kjo i thjeshton situatat e ndryshme, pasi të gjithë **qytetarët jo-europianë** përkufizohen si të njëjtë. Disa fjalë përdoren me një konotacion të kundërt, të tilla si termat "klandestinë" ose "migrantë të paligjshëm" që përdoren në vend të "person migrant në një situatë të parregullt". Kjo sjell përshtypjen e gabuar se njerëzit mund të jenë të paligjshëm: asnjë person nuk është në thelb i paligjshëm, vetëm veprimet mund të jenë të paligjshme nëse nuk respektohet ligji. Mediat zakonisht e përshkruajnë temin e migracionit si një "problem", "një krizë" dhe migrantët si një "masë". Është vërtetuar se media formëson mënyrën se si ne e shohim botën dhe krijon imazhe të forta që ndryshojnë mënyrën se si i shohim njerëzit në lëvizje: një keqpërdorim i tillë i fjalëve mund të çojë në sjellje negative ndaj migrantëve, si dhe ndaj kujtqdo që duket se është nga jashtë. Prandaj është thelbësore të njohim termat dhe përdorimin e saktë të tyre.

1. 3. Migracioni është një e drejtë e njeriut

Ligji ndërkombëtar i garanton të gjithëve lirinë e lëvizjes. E drejta ndërkombëtare është një fushë e së drejtës që u jep shteteve përgjegjësi në marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin dhe në mënyrën se si i trajtojnë individët. Edhe pse ka debate nëse e drejta ndërkombëtare është efikase, pasi është e vështirë të zbatohet, shtetet që janë pjesë e traktateve ndërkombëtare pranojnë dhe bien dakord për disa vlera.

Për shembull, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut është një grup prej 30 të drejtash për të cilat u ra dakord nga shtetet pas Luftës së Dytë Botërore. Ky dokument ofron një sërë të drejtash që "të gjithë duhet t'i kenë". Të 192 shtetet që njihen nga Kombet e Bashkuara, pra praktikisht e gjithë bota, kanë rënë dakord të respektojnë këto të drejta: si rezultat, edhe nëse Deklarata nuk është ligjërish e detyrueshme për shtetet, krahasuar me marrëveshjet apo traktatet ndërshtetërore, ky Dokument ka një vlerë simbolike shumë të lartë, një vlerë aq të fortë sa shtetet konsiderojnë se janë të detyruara t'i respektojnë këto të drejta. Sipas këtij dokumenti, çdokush ka të drejtë të kërkojë dhe të gëzojë azil në vendet e tjera nga persekutimi (neni 14), secili ka të drejtën e një shtetësie (neni 15 (1)), dhe askush nuk mund të privohet nga shtetësia e tij ose t'i mohohet e drejta e tyre për të ndryshuar shtetësinë e tyre pa një arsye të vlefshme (neni 15 (2)).

Për më tepër, liria e lëvizjes mbrohet edhe në nivel europian. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut është një dokument në nivel europian që rendit një grup të drejtash që shtetet ligjërish duhet t'i respektojnë. Këto të drejta gjithashtu përmbahen pak a shumë në të njëjtën mënyrë në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Sipas këtij dokumenti, çdokush është i lirë të largohet nga çdo vend, duke përfshirë edhe vendin e tij. Për këtë dokument është rënë dakord nga shumica dërrmuese e vendeve të Bashkimit Europian, gjë që e bën atë shumë të rëndësishëm.

Pra, liria e lëvizjes mbrohet në nivel ndërkombëtar, në dokumente për të cilat është rënë dakord. Liria për të lëvizur nënkupton lirinë për të hyrë dhe për t'u vendosur në një vend tjetër: kështu, të drejtat për hyrje, qëndrim dhe dalje janë të pandashme.

Për më tepër, migrantët janë një grup vulnerabël dhe janë të mbrojtur për këtë arsye. Ata janë vulnerabël sepse nuk janë shtetas të vendit ku jetojnë, kanë kaluar një kufi ndërkombëtar dhe përgjithësisht lejohen të hyjnë dhe të jetojnë në një vend tjetër vetëm me pëlqimin e autoriteteve (ndryshe nga shtetasit). Shpesh ata duhet të kalojnë nëpër procese administrative për të fituar të drejtën e qëndrimit në vend për një periudhë më të gjatë kohore. Ata janë gjithashtu të huaj për shoqërinë ku jetojnë dhe mund të ndihen sikur nuk i përkasin, veçanërisht pasi shpesh nuk e njohin gjuhën, kulturën, ligjet, praktikat. Kjo e bën më të vështirë për ta, aksesin në të drejtat e tyre. Ata gjithashtu mund të përballen me diskriminim, mundësi të pabarabarta, si dhe racizëm ose ksenofobinë. Ata me status të parregullt imigrimi në vend, kanë më shumë gjasa të jenë në fokus të abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit, nga punëdhënësit, agjentët e migracionit, kontrabandistët, etj. Gjatë kohërave të tensioneve politike, ata mund të dyshohen dhe trajtohen si rreziqe sigurie nga politikanët dhe mund të jenë viktimë të racizmit dhe ksenofobisë nga shoqëria. Për shembull, pas sulmeve islamike pati shumë stigmatizim rreth emigrantëve dhe njerëzve me prejardhje migratore.

Si pasojë e këtij vulnerabiliteti, të drejtat e migrantëve, azilkërkuesve, refugjatëve mbrohen nga ligji ndërkombëtar. Nuk ka rëndësi nëse ata kanë mbërritur legalisht apo ilegalisht: të gjithë duhet të gëzojnë një sërë të drejtash bazë. Sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, shtetet janë të detyruara të mos sulmojnë të drejtat e migrantëve, por ato gjithashtu duhet të parandalojnë shkeljet e këtyre të drejtave dhe të veprojnë në mënyrë që të sigurohen që këto të drejta të zbatohen. Shtetet kanë gjithashtu një detyrë specifike për t'u kujdesur për migrantët veçanërisht vulnerabël. Këto të drejta mbrohen në nivel ndërkombëtar në dokumente të tilla si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa për Refugjatët dhe Konventa e Punëtorëve Migrantë.

Kapitulli 2

Migrimi në BE: ligjet, institucionet dhe tendencat aktuale

2.1. Një politikë e përbashkët për migracionin në BE

Sipas Këshillit të Europës^[11], institucionet europiane kanë objektiv të krijojnë një politikë migracioni efektive, humanitare dhe të sigurt. Brenda Bashkimit European, shtetet kanë një politikë të përbashkët për migracionin. Kjo do të thotë se institucionet europiane krijuan një sërë rregullash në lidhje me migrimet që çdo shtet duhet t'i respektojë: për shembull për menaxhimin e mbërritjes së migrantëve, mjediset e pritjes, procedurat e azilit dhe kthimit, mbrojtjen e migrantëve vulnerabël etj.

Ky sistem i përbashkët i migracionit u krijua si rezultat i zonës Shengen. Në zonën Shengen, të gjithë janë të lirë të lëvizin ndërmjet shteteve, nuk duhet të ketë kontrolle kufitare midis vendeve të ndryshme. Ai synon të lehtësojë shkëmbimet e mallrave dhe shërbimeve ndërmjet shteteve. Për shkak se nuk duhet të ketë kontrolle kufitare brenda BE-së, të gjithë lejohen të qarkullojnë kudo, pavarësisht nëse janë shtetas apo jo. Kjo nuk vlen vetëm për qytetarët e Bashkimit European, por për të gjithë, sepse nuk ka mundësi të dihet nëse dikush është shtetas pa kontrolluar dokumentet e tij.

Në mënyrë progresive, qytetarët e BE-së u bënë të barabartë dhe BE-ja krijoi një shtetësi të përbashkët europiane: një francez ose një person spanjoll, për shembull, është gjithashtu automatikisht european dhe mund të jetojë në një vend tjetër të BE-së, të votojë në zgjedhje të caktuara, e kështu me radhë. Por nuk është kështu. Nuk do të thotë që njerëzit që nuk janë qytetarë europianë janë të barabartë me qytetarët europianë, edhe nëse jetojnë në BE: BE-ja ka krijuar një status të privilegjuar për ata migrantë që kanë status të rregullt në një shtet anëtar, por gjithashtu ka forcuar luftën kundër "migrantëve të parregullt", ata që nuk kanë status ligjor në asnjë shtet të Bashkimit European. Kjo luftë shpesh zhvillohet në kurriz të të drejtave të njeriut.

Në fillim të kësaj politike të përbashkët europiane, në vitin 1999, ideja e Bashkimit European ishte shumë pozitive: politikanët besonin se BE-ja duhet t'u ofronte të mirën e saj më të çmuar, lirinë, të gjithëve, përfshirë edhe atyre jashtë Bashkimit. Në fakt, ideja ishte më tepër që kjo liri dhe këto të drejta t'u ofroheshin atyre që shtetet zgjidhnin: shpesh t'i jepej atyre që duhej të punonin e të ndërtonin. Megjithatë, nga viti 2008, një "ndryshim sigurie" ndodhi pas sulmeve të para terroriste, si dhe pas valës së rëndësishme të migracionit në 2015. Politikat u bënë shumë më kufizuese ndaj migrantëve. Aktualisht, ajo që nga ekspertët konsiderohet si një zhvendosje e re e sigurisë, po ndodh në nivel european, përmes "Paktit të Ri European për Migracionin dhe Azilin". Objektivi kryesor i kësaj politike është filtrimi i migrantëve që mbërrijnë në kufijtë europianë: ata që kanë më pak gjasa të marrin statusin e azilit do të trajtohen përmes një procesi të ndryshëm në krahasim me ata që konsiderohen më të prirur për të marrë statusin e azilit.

Të parët do të mbaheshin në qendra të mbyllura, ku kërkesa e tyre për azil do të shqyrtohet në mënyrë të përsheptuar. Sipas OJQ-ve, ky rregull do të vendoste një pabarazi mes migrantëve, pasi ata do të trajtoheshin ndryshe në bazë të vendit të tyre të origjinës. Për më tepër, kjo procedurë e përsheptuar ka të ngjarë të rezultojë në më pak të drejta për migrantët e ndaluar, më pak akses te avokatët dhe këshilltarët, më pak akses në shërbime të tjera. Duhet theksuar se zyrtarisht, përparësia e kësaj procedure është dërgimi më lehtësisht i atyre që nuk marrin një status ligjor nga vendi i tyre i origjinës, pasi këta njerëz do të jenë më pak të mbrojtur. Në të vërtetë, këto qendra do të konsideroheshin ligjërisht se nuk janë pjesë e territorit europian, edhe nëse fizikisht janë në terrenin europian. Pra, të strehuarët në këto qendra do të gëzonin më pak të drejta dhe mbrojtje, ashtu si në vendet e tjera të BE-së. Për ta përmbledhur, kjo rregullore e re është krijuar për të ruajtur një logjikë sigurie dhe të numrave, në vend të njerëzve.

Ekziston një politikë e përbashkët europiane midis shteteve anëtare, por çdo shtet është plotësisht përgjegjës: në zbatimin e saj, si dhe në vendosjen për të, nëpërmjet institucioneve europiane. Kështu, çdo qytetar europian ka fuqinë të ndikojë në politikën e përbashkët për migracionin.

2.2. Kontrollat kufitare në kufijtë e BE-së

Për shkak se nuk duhet të ketë kontrolle kufitare brenda Bashkimit Europian, u vendos nga politikanët që BE-ja duhet të përforcojë kontrollet e saj në kufijtë e jashtëm. Qëllimi i caktuar i këtyre kontrolleve është parandalimi i "migrimit të parregullt": sipas faqes së tyre të internetit^[12], Komisioni Europian sigurohet që çdo vend evropian në kufirin e Bashkimit Evropian të kontrollojë pjesën e tij të kufirit. Ai gjithashtu pretendon të sigurohet që të drejtat themelore të migrantëve të respektohen. Ka vërtet një theks në kontrollet e kufirit, në shmangien e atyre që vëzhguesit i quajnë emigrantë "të padëshiruar" ose "jo të pranuar": ata që mbërrijnë në mënyrë të parregullt në territorin e BE-së, punëtorë të pakualifikuar. Vetëm atëherë hyjnë në fuqi të drejtat themelore. Kjo realizohet përmes institucioneve dhe ligjeve, për shembull politika për kontrabandistët.

Politika për kontrabandistët synon njerëzit që ndihmojnë emigrantët të kalojnë ilegalisht kufijtë evropianë. Mund të nënkuptojë t'i ndihmohet ata të hyjnë në BE, por edhe të udhëtojnë brenda BE-së. Në faqen e tyre të internetit^[13], Komisioni Europian thekson se kontrabandistët shkelin të drejtat e njeriut të emigrantëve dhe se veprimet e tyre mund të çojnë në vdekjen e emigrantëve, veçanërisht në detin Mesdhe. Është vërtet e paligjshme të lehtësosh hyrjen e paligjshme të një personi në një shtet, për përfitime financiare ose materiale (neni 3 i Protokollit të Kontrabandës së Emigrantëve). Kontrabandistët, të cilët shpesh janë pjesë e grupeve më të mëdha kriminale, marrin shuma të mëdha parash nga njerëz vulnerabël që dëshirojnë të kalojnë kufijtë e BE-së.

Udhëtimet shpesh zhvillohen në kushte shumë të rrezikshme. Megjithatë, “migrimi i ligjshëm”, për shembull, përmes vizave, është bërë gjithnjë e më i rrallë dhe i vështirë, sepse politika europiane për migracionin është bërë gjithnjë e më e vështirë. Ka vetëm shumë pak mënyra për të ardhur ligjërisht në BE: viza për punëtorët e huaj, studiuesit ose studentët, martesë me një qytetar të BE-së ose proceset e bashkimit familjar për përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare (refugjatët). Sidomos për ata që vijnë nga vendet në zhvillim, ose ata që u mungon pasuria financiare ose kulturore, procesi mund të jetë i vështirë dhe normat e pranimit ndryshojnë shumë sipas vendit të origjinës. Ky është rezultat i politikës së Shengenit: për shkak se kufijtë brenda BE-së janë të hapur, politikanët kanë vendosur që duhet të jetë më e vështirë për të hyrë në BE.

Për më tepër, sipas mbrojtësve dhe ekspertëve të të drejtave të njeriut, politika për kontrabandistët nuk prek vetëm njerëzit që fitojnë para nga ndihma e migrantëve për të kaluar kufijtë: ajo prek gjithashtu OJQ-të dhe aktivistët, të cilët akuzohen për kontrabandë dhe krime të lidhura me të kur ata në të vërtetë synojnë të mbrojnë të drejtat e njeriut të migrantëve. Për shembull, në Greqi, në vitin 2021, 24 aktivistë u akuzuan nga autoritetet për trafikim njerëzor dhe spiunazh. Në fakt, ata po kryenin misionë kërkim-shpëtimi për të shpëtuar emigrantët, varkat e të cilëve po mbyteshin. Ata u shpallën të pafajshëm në vitin 2024, por shumë OJQ që kryejnë misionë të ngjashme ose madje ofrojnë shërbime falas për migrantët (ndihmë juridike, ushqim, veshje) akuzohen rregullisht nga autoritetet, hetohen nga policia ose vendosen në gjykim.

Nga ana praktike, kontrollet në kufijtë e jashtëm të Bashkimit European kryhen në mënyrë të përbashkët, ndërmjet anëtarëve të BE-së. Zyrtarisht, ideja është mbrojtja kolektive e territorit european. Për të realizuar këto kontrolle përdoren dy mjete kryesore.

I pari është sistemi i Europolit, i cili mundëson shkëmbimin e informacionit (përfshirë ato personale) ndërmjet shteteve anëtare. Kjo do të thotë se shtetet janë në gjendje të kontrollojnë se kush hyn në BE, të dinë nëse personi lejohet apo jo, nëse është refuzuar më parë, nëse ka kërkuar azil në një vend tjetër të Bashkimit European.

E dyta është Agjencia Europiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare (Frontex), një institucion që synon të mbështesë shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e lidhura me Shengenin kur ato menaxhojnë kufijtë e jashtëm të BE-së. Një institucion i rëndësishëm i Frontex-it është “korpusi në këmbë”, i përbërë nga rojet kufitare dhe bregdetare. Ata kanë për detyrë, ndër të tjera, të kontrollojnë kufijtë e jashtëm të BE-së. Ata kryejnë kontrolle kufitare, regjistrojnë emigrantët që vijnë, por kanë edhe detyrën të bëjnë operacione kërkim-shpëtimi. Kjo do të thotë që ata kryejnë operacione kërkimi, duke ngarë varkat në det për shembull ose duke dërguar drone për të kontrolluar një zonë dhe duke kërkuar emigrantë në rrezik. Më pas, ata njoftojnë autoritetet e shtetit anëtar përkatës nëse zbulojnë migrantë që duhet të shpëtohen: autoritetet e vendit duhet t'i shpëtojnë emigrantët dhe t'i sjellin në një breg european, në mënyrë që ata të mund të kërkojnë azil. Por në vend të kësaj, ka pasur shumë akuza nga OJQ-të kundër Frontex se ata dështuan të lëshonin alarme për varkat në rrezik.

Për më tepër, njerëzit që mbërrijnë në kufirin e Bashkimit European mund të jenë viktimat të "shtyrjeve sa andej këndej": kjo është kur, në vend që t'i çojnë në brigjet europiane, autoritetet i shtyjnë varkat përsëri në brigjet libiane ose turke, shpesh pasi u marrin motorin ose kryerja e akteve të dhunshme ndaj migrantëve. Këto operacione çojnë në vdekjen e njerëzve në det, dhe kjo është shumë traumatike për të mbijetuarit. Është gjithashtu e paligjshme, pasi i pengon njerëzit të kërkojnë azil në BE, e cila është një e drejtë për të gjithë. Frontex është akuzuar disa herë për mbulim apo edhe financim të pjesshëm të operacioneve të tilla[14]. Për më tepër, lidhur me këtë çështje është bërë një marrje në pyetje parlamentare në nivel të BE-së[15].

Për më tepër, ne kuptuam se nuk ka kontrolle kufitare brenda zonës Shengen, që është praktikisht i gjithë territori i BE-së. Megjithatë, rregulloret europiane u japin leje shteteve anëtare që të rivendosin përkohësisht kontrollet në kufijtë e tyre. Megjithatë, kohëzgjatja duhet të jetë e kufizuar dhe kjo mund të ndodhë vetëm si mjet i fundit. Megjithatë, disa vende të BE-së kanë rivendosur rregullisht kontrollet kufitare në vitet e fundit për periudha të gjata kohore (nga disa muaj në një vit). Që nga viti 2015, Franca ka rikthyer kontrollet kufitare 19 herë, Spanja 18 herë dhe Italia 8 herë. Mund të konsiderohet se rivendosja e kufijve vë në pikëpyetje të gjithë logjikën e forcimit të kontrolleve jashtë kufijve, pasi ato u vendosën si rezultat i mungesës së kontrolleve kufitare brenda Bashkimit European.

2.3. Migrimi në Spanjë, Itali, Francë apo Shqipëri

Francë

Në vitin 2022, në Francë jetonin 7 milionë emigrantë. 48,2% e tyre kanë lindur në Afrikë, 32,2% në Europë. Algjeria, Maroku dhe Portugalia ishin vendet kryesore të origjinës[16]: kjo mund të shpjegohet me faktin se këto vende janë ish-vende të kolonizuara, ose janë arratisur në të kaluarën për shkak të situatës politike. Franca mirëpret rreth 200 000 emigrantë në vit: 90 000 prej tyre vijnë për t'u bashkuar me familjen e tyre dhe 60 000 prej tyre janë studentë[17]. Megjithatë, opinioni i përgjithshëm është përgjithësisht kritik ndaj imigracionit. Sipas sondazheve, 60 deri në 63% e të anketuarve pajtohen me fjalinë "Ka shumë emigrantë në Francë". Shifrat kanë qenë të qëndrueshme që nga vitet 2010[18]. Kjo pasqyron një pikëpamje të përgjithshme se nëse Franca do të mirëpresë shumë emigrantë, do të "pushtohet", kur shifrat dëshmojnë të kundërtën.

Tema është veçanërisht e pranishme në media, për shkak të frikës së humbjes së statusit ekonomik ose të "identitetit". Këto frikëra janë mjaft të zakonshme në mesin e popullatës franceze, por ato përdoren edhe nga partitë që mbrojnë idetë kundër emigracionit. Këto parti këmbëngulin edhe në ndjenjën e pasigurisë, që lidhen me emigracionin. Besimet kundër imigracionit ushqehen nga supozimi i zakonshëm se të huajt do të kryenin më shumë krime sesa popullsia e përgjithshme: ndërsa të huajt janë me të vërtetë të mbipërfaqësuar në burgje, kjo mund të shpjegohet nga disa faktorë.

Së pari, krimet ku të huajt janë më të përfaqësuar janë krimet që zbulohen më së shumti nga policia: puna e paligjshme, qëndrimi i paligjshëm... Emigrantët janë gjithashtu më të dukshëm në krimet që lidhen me mjedisin e klasës punëtore. Këto statistika duhet të lidhen me pabarazitë sistematike që mbeten midis atyre që kanë një sfond migrimi dhe atyre që nuk e kanë. Aktivistët dhe organizatat e shoqërisë civile dënojnë faktin se të huajt kontrollohen më shpesh nga policia, për shkak të përfaqësimeve raciste që mbeten në forcat e policisë. Kriminelët e huaj gjithashtu futen në burg më shumë se të tjerët (paraburgimi i përkohshëm dhe ndalimi policor); Është vërtetuar se dikush që është vënë në paraburgim të përkohshëm ose në paraburgim ka më shumë shanse për të marrë një dënim të gjatë me burg sesa dikush që del i lirë para gjykatësit.

Një ligj i ri mbi imigracionin u miratua në dhjetor 2023 nga parlamenti francez dhe u përshkrua si një "fitore ideologjike" nga e djathta ekstreme.



Ky ligj përfshin:

- Kufizimet për ndihmat sociale: do t'u kërkohet emigrantëve që nuk punojnë të jetojnë në Francë për më shumë kohë derisa të marrin ndihmë sociale sesa emigrantët që punojnë.
- Kuotat e migracionit të vendosura nga Parlamenti.
- Mundësia e heqjes së shtetësisë për personat me nënshtetësi të dyfishtë nëse ata janë dënuar për vrasje me dashje ndaj njerëzve në "pozitën e autoritetit publik" (polici...). Kjo përfaqëson një pabarazi të fortë midis njerëzve që kanë një sfond migrimi dhe njerëzve që nuk e kanë.
- Personat e lindur në Francë nga prindër të huaj do të duhet të aplikojnë për kombësinë franceze, atyre nuk do t'u jepet më automatikisht. Kjo krijon një pabarazi mes tyre dhe njerëzve lindur me prindër francezë.
- Rikthehet "vepra e qëndrimit të paligjshëm", e dënueshme me gjobë.
- Studentët e huaj do të duhet të lënë një depozitë, që do të thotë se i japin shtetit një shumë parash, të cilën e marrin vetëm kur të largohen nga vendi.

Ndërsa shumë nga këto masa janë bllokuar nga Conseil d'État, juridiksioni më i lartë administrativ i Francës, i ngarkuar me kontrollin e ligjeve, ky ligj demonstroi një ndryshim sigurie në politikën e imigracionit në Francë.

Italia

6 milionë të huaj jetojnë në vend. Një çështje qendrore është ajo e mijëra njerëzve në mërgim që kanë zbarkuar në brigjet italiane, nga vende të tilla si Tunizia, Nigeria, Bangladeshi, Bregu i Fildishtë. Rreth 15% e tyre janë të mitur të pashoqëruar. Ka rrezik më të lartë që emigrantët, veçanërisht të parregullt, të vuajnë nga varfëria, papunësia, përjashtimi social ose t'i nënshtrohen trafikimit dhe shfrytëzimit^[19].

Spanjë

Spanja është një destinacion dhe një vend tranzit për migrimet ndërkombëtare. 5.5 milionë emigrantë jetojnë në vend në vitin 2022, kryesisht nga Maroku, Rumania, Kolumbia dhe Britania e Madhe. Shumë migrantë udhëtojnë për në Spanjë përmes Rrugës së Afrikës Perëndimore, një nga rrugët më vdekjeprurëse të migrimit, dhe mbërrijnë në Spanjë kryesisht përmes ishullit Kanarie, ose ngushticës së Gjibraltarit dhe në rrugë tokësore në qytetet e Ceutës dhe Melilla^[20].

Shqipëria

Shqipëria ka një popullsi migrante prej 0.53%, kryesisht nga Greqia, Italia, SHBA dhe Turqia. Vendi po bëhet gjithashtu një vend i njohur tranziti për emigrantët që shkojnë në BE: ata hyjnë në Shqipëri nga Greqia, më pas bashkohen me Malin e Zi dhe shkojnë në Itali. Një çështje tjetër është ajo e migrimit të brendshëm në vend: njerëzit lëvizin nga zonat rurale drejt qyteteve më të mëdha, por edhe nga zonat e varfra urbane drejt qyteteve më dinamike. Për shkak të papunësisë, varfërisë dhe mungesës së sigurisë individuale, shumë njerëz të arsimuar largohen nga vendi, për një kujdes shëndetësor dhe kushte jetese jashtë vendit më të mira^[21].

Aktiviteti 2

Ndiqui udhëtimin e një gruaje emigrante



2.4. Përqëndrimi në azilkërkim

Azili është mbrojtja që lejon njerëzit të qëndrojnë në një vend dhe të mos kthehen në një vend ku kanë frikë nga persekutimi ose dëmtimi. Personat të cilëve u jepet kjo mbrojtje quhen “refugjatë”, ata njihen si refugjatë.

Sipas ligjit, një refugjat është

"Dikush që nuk është në gjendje ose nuk dëshiron të kthehet në vendin e origjinës, për shkak të frikës bazuar në faktin se do të persekutohet për arsye race, feje, kombësie, anëtarësi në një grup të caktuar shoqëror ose opinion politik."



Kjo ka lidhje me një status shumë specifik: jo të gjithë mund të marrin statusin e refugjatit, ka kriterë në të cilat njerëzit duhet të përmbushin nëse duan të marrin statusin:

- **Personi u largua nga vendi i tij dhe nuk mund të kthehet pasi ka frikë se mund t'i ndodhë diçka.** Duhet të jetë një frikë e bazuar në diçka të fortë: një frikë objektive që duhet të besohet edhe nga personi që do të shqyrtojë kërkesën. Në teori, aplikantët nuk kanë nevojë të provojnë se ka pasur një sulm në të kaluarën, por ata duhet të provojnë se ka arsye të forta për të besuar se do të ishin në rrezik nëse kthehen. Në praktikë, personi që do të shqyrtojë kërkesën ka më shumë gjasa të besojë se është në rrezik përndjekjeje në vendin e tij nëse personi ka qenë viktimë e persekutimit në të kaluarën.
- Personi mund të ketë frikë nga sulmet e shtetit (policia, ushtria...) ose dikush tjetër, por **duhet të vërtetojnë se shteti nuk mund t'i mbrojë.**
- **Duhet të jetë një frikë personale,** do të thotë se ato mund të dëmtohen për shkak të identitetit të tyre: për shkak të racës, fesë, kombësisë, opinionit politik ose anëtarësimit në një grup të caktuar shoqëror (për shembull, gratë mund të jenë në shënjestër sepse janë gra).
- Aplikantët gjithashtu duhet të vërtetojnë se edhe sikur të zhvendosen nesër në vendin e tyre, **rreziku do të ishte po njësoj i madh,** edhe nëse do të shpërnguleshin në një pjesë tjetër të vendit për t'u strehuar.

Dikush që dëshiron të marrë statusin e refugjatit duhet të kalojë një proces, ku do të vlerësohet nëse personi përputhet me kriteret. Barra e provës bie mbi azilkërkuesit: kjo do të thotë që vetë azilkërkuesit do të provojnë se u përgjigjen kriterëve, të cilat mund të jenë shumë të ndërlikuara. Si të vërtetohet se ka pasur një rrezik? Shumë herë nuk ka prova dhe shumë paragjykime kohore të personit që shqyrton kërkesën mund të luajnë një rol nëse ai do ta shohë atë të besueshme apo jo. Për shembull, personave LGBTQ që kërkojnë azil sepse janë të persekutuar si homoseksualë, lezbike ose transgjinorë, mund t'u kërkohet të provojnë se janë LGBTQ. Për shembull, ata pyeten rregullisht se si e kanë kuptuar se janë LGBTQ, gjë që është shumë e vështirë për t'u shpjeguar, veçanërisht pasi është diçka që u është dashur ta fshehin gjatë gjithë jetës së tyre, kështu që mund të ndihen jo rehat ta ndajnë atë me një të huaj. Për më tepër, personi që shqyrton kërkesën e tyre mund të përdorë pikëpamjet e tij Perëndimore për të shqyrtuar nëse është e besueshme që personi mund të jetë LGBTQ apo jo. Për shembull, ata mund ta bazojnë vendimin e tyre në pamjen e personit dhe të mos i besojnë aplikantit nëse nuk korrespondojnë me këto besime.

Proçeset janë të ndryshme në çdo vend, por Bashkimi European ka vendosur një rregullore për të siguruar që proçesi të zhvillohet në mënyrë dinjitoze. Shtetet gjithashtu duhet të sigurohen që rastet e azilit të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe që kërkesa e tyre për azil të shqyrtohet sipas standardeve uniforme, dhe se rezultati do të ishte i njëjtë kudo që të shqyrtohet kërkesa. Ka disa pika të përbashkëta në proçes në çdo vend: personi regjistrohet fillimisht si azilkërkues, regjistrohen të dhënat e tij personale si dhe shenjat e gishtave, pastaj zakonisht bëhet një intervistë dhe nëse pas intervistës ata marrin një vendim negativ, , ata mund ta apelojnë vendimin përmes Gjykatës.

Ekziston gjithashtu një mundësi për të aplikuar sërish për statusin, në rast se përpjekja e parë nuk ka sukses dhe pas kërkesës shfaqen elementë të rinj. Por vendet e ndryshme të BE-së kanë politika të ndryshme për sa i përket azilit, ato mund të kenë më shumë gjasa të pranojnë kërkesat për azil ose t'i japin migrantëve urdhër për t'u larguar dhe proceset mund të kenë kohëzgjatje të ndryshme sipas vendit (9 muaj në Gjermani, 17 muaj në Austri).

Cili shtet është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës së një azilkërkuesi? Rregullorja e Dublinit është ligji europian që përdoret për të përcaktuar se cili vend do të shqyrtojë një kërkesë për azil.

Ekzistojnë 3 kritere kryesore:

- Nëse personi ka një anëtar të familjes të pranishëm në një vend tjetër të BE-së: atëherë aplikanti mund të kërkojë t'i bashkohet atij, kjo kërkesë duhet të shqyrtohet.
- Nëse personi ka ose ka pasur në të kaluarën një vizë ose një leje qëndrimi të lëshuar nga një vend tjetër i BE-së: atëherë ai mund të bashkohet me atë vend nëse kërkesa pranohet.
- Nëse ata kanë udhëtuar në, apo përmes një vendi tjetër të BE-së.

Situata e tretë është shumë e zakonshme. Shumë njerëz që mbërrijnë në Europë udhëtojnë përmes Turqisë ose Libisë dhe fillimisht mbërrijnë në Greqi dhe Itali, por më pas udhëtojnë në vendet veriore si Franca ose Gjermania. Nëse shenjat e gishtave të tyre janë regjistruar në vendet europiane që kanë kaluar fillimisht, ata nuk mund të kërkojnë azil në asnjë vend tjetër të BE-së, sepse hyrja e tyre në një vend tjetër zbulohet nga një sistem i përbashkët. Ose detyrohen të deportohen në atë vend tjetër, ose mund të regjistrojnë një kërkesë për azil në vendin ku ndodhen, por vetëm pas një periudhe të caktuar kohore. Pra, azilkërkuesit nuk zgjedhin se ku kërkojnë azil. Ky sistem po rëndon tej mase vendet europiane si Italia dhe Greqia, ku shërbimet administrative mbingarkohen, sepse ka shumë kërkesa në krahasim me kapacitetet. Kjo ndikon në kohëzgjatjen e procedurave, mënyrën se si do të përpunohet kërkesa, akomodimi... Për shembull, Greqia njihet si një Shtet i dështuar në lidhje me trajtimin e keq që u bëhet azilkërkuesve në këtë vend. Pavarësisht se emigrantët duhet të transferohen në vende të tjera europiane, kjo në fakt ndodh shumë rrallë.

Në vitin 2022, 962 160 kërkesa për azil u depozituan në BE (nga shtetas jo të BE-së): kryesisht nga sirianë, afganë, turq dhe venezuelianë. Gjermania mori më shumë aplikime për herë të parë (25%), pastaj Franca (16%) dhe Spanja (12%) [22]. Sot, sipas ekspertëve, faktet tregojnë se BE-ja nuk është në gjendje të sigurojë kushte dinjitoze të pritjes për azilkërkuesit. Ekziston gjithashtu një tendencë për të kufizuar aksesin në të drejta dhe shërbime për azilkërkuesit.

Edhe nëse BE-ja ka vendosur standarde bazë për kushtet e pritjes, këto ndryshojnë kryesisht sipas vendeve: psh fillon si Greqia dhe Holanda që ofrojnë akomodim në streha kolektive, deri tek akomodimi individual në disa shtete si psh Gjermani dhe Suedia. Faktorë të tjerë si ndihma financiare, kujdesi shëndetësor dhe akses në tregun e punës për azilkërkuesit gjithashtu ndryshojnë. Në fakt, kushtet e pritjes ndryshojnë sipas vendndodhjes gjeografike.

- Vendet jugore si Greqia dhe Italia shpesh nuk e konsiderojnë veten si vende që u japin azil njerëzve dhe priren të mos ofrojnë kushte bazë të pritjes. Autoritetet greke kanë ndërtuar qendra pritëse që janë të destinuara për të pritur azilkërkuesit në javët e para të procesit të tyre, përpara se ata të transferohen në akomodime të tjera. Këta kanë kushte shumë të këqija, për shembull ka mungesë uji, kanalizime, akses në ushqim, akses në kujdes shëndetësor... Dhe në realitet, shumë azilkërkues qëndrojnë në këto kampe gjatë gjithë kohës së procedurave të tyre, shpesh me muaj apo edhe vite. Procedurat në këto kampe janë të gjata, sepse shpeshherë sistemet mbingarkohen.
- Vendet në Europën Qendrore konsiderohen si "vende tranzit" dhe investojnë pak në strehimin që u ofrojnë azilkërkuesve, gjë që ia bën të vështirë autoriteteve t'i ofrojnë strehimin e duhur aplikantëve.
- Edhe brenda vendeve të ndryshme europiane, ka lloje dhe cilësi të ndryshme akomodimi, sipas vendndodhjes së akomodimit, madje edhe sipas kombësive të azilkërkuesve.

Kapitulli 3

Vulnerabiliteti dhe migracioni: grumbull diskriminimesh



3.1 Gratë

Ndërkohë që të gjithë migrantët mund të konsiderohen si njerëz vulnerabël, gratë janë edhe më të cënueshme në rrugën e migrimit dhe pas mbërritjes në Europë.

Ndërsa gratë migrojnë për arsye të ndryshme, duke përfshirë varfërinë, konfliktet dhe fatkeqësitë klimatike, dhuna me bazë gjinore është një nga shkaqet kryesore të migrimit mes tyre. Dhuna ndodh në të gjithë rrugëtimin e e migracionit që do të thotë para, gjatë dhe pas migrimit. Përdhunimi ishte forma më e raportuar e dhunës seksuale mes grave refugjate në nivel global. Gratë emigrante dhunohen veçanërisht në vendin e origjinës, kryesisht nga partnerë intimë, njerëz që supozohet t'i mbrojnë ato. Shumë gra i shpëtojnë dhunës si martesë e hershme dhe e detyruar, gjymtimi i organeve gjenitale femërore, diskriminimi me bazë gjinore, dhuna seksuale ose dhuna në çift dhe brenda familjes.

Në rrugën e migrimit, gratë përballen me rreziqe më të larta të dhunës nga kontrabandistët, trafikantët, migrantët e tjerë, si dhe nga zyrtarët shtetërorë.

Ata përballen me rrezikun e lartë të shfrytëzimit (për shembull shfrytëzimi seksual dhe prostitucioni i detyruar), si dhe përdhunimet. Rreziku që ato të trafikohen gjithashtu shtohet: disa gra migrante, veçanërisht ato që nuk kanë dokumente për të hyrë dhe qëndruar ligjërisht në një vend, mund të mos jenë në gjendje t'i paguajnë kontrabandistët e tyre për të kaluar kufijtë. Ata shpesh kanë borxhe ndaj tyre dhe mund të trafikohen dhe/ose abuzohen seksualisht për të shlyer këto borxhe. Ekziston gjithashtu një rrezik më i lartë që gratë të kapen nga bandat kriminale.

Në vendet e destinacionit, gratë përballen me dhunë seksuale dhe me bazë gjinore në vendin e punës dhe në hapësirat publike, veçanërisht kur janë të detyruara të jetojnë në rrugë prej mungesës së akomodimit shtetëror, por edhe aty ku jetojnë, dhe aq më tepër kur arrestohen për shkak të statusit të tyre të migrimit. Kur ato punojnë, shumica dërrmuese e tyre janë në punë shërbimi (përfshirë punën shtëpiake dhe kujdesin shëndetësor), shpesh ndodh në mënyrë të paligjshme në ekonominë informale: ata nuk përfitojnë nga të njëjtat mbrojtje të punës dhe janë në rrezik të abuzimit të të drejtave të punës, dhuna seksuale dhe me bazë gjinore, racizmi dhe ksenofobia. Kur punësohen si punonjëse shtëpie, për shembull si pastruese, dado ose kujdestare shtëpie, ato janë edhe më të rrezikuar nga abuzimi, sepse shpesh jetojnë në të njëjtin vend me punëdhënësit e tyre: janë më të izoluara dhe më të varura nga punëdhënësit. Abuzimi mund të marrë forma të ndryshme: mbajtja e pagave ose dokumenteve, orët dhe ngarkesat e tepërta të punës, privimi nga ushqimi, kushtet e papërshtatshme të jetesës...

Për më tepër, në vendin e destinacionit, vetëm 22% e migrantëve që punojnë mbulohen nga mbrojtja sociale: pa rrjeta sigurie, gratë migrante mund të humbasin jetesën dhe aftësinë për të siguruar familjet e tyre, duke përfshirë edhe momentet kur sëmuren. Për gratë mbetet e vështirë të raportojnë abuzimin, për shkak të mungesës së procedurave efektive, dhe të kenë akses në shërbime.

3.2 Personat LGBTQ+

Për sa u përket migrantëve që janë LGBTQ+, ndërkohë që shumë arsye mund t'i shtyjnë ata të largohen nga vendi i tyre, ata shpesh ikin nga vendet e tyre të origjinës për shkak të përjashtimit socio-ekonomik ose sepse kanë qenë viktimë të persekutimeve dhe nuk marrin mbrojtje.

Diskriminimet strukturore me të cilat ata përballen përkeqësohen nga situata e tyre si migrantë: kur lëvizin brenda vendit të tyre, veçanërisht kur marrëdhëniet e të njëjtit seks dhe/ose identiteti i ndryshëm gjinor kriminalizohen, migrantët LGBTQ+ shpesh nuk merren parasysh nga institucionet që mbështesin personat e zhvendosur brenda vendit.

Ndërsa janë në lëvizje në një vend tjetër, ata kanë më shumë gjasa të përballen me shkelje të të drejtave të njeriut nga kontrabandistët, trafikantët, madje edhe oficerët e imigracionit: 83% e viktimave të trafikimit që janë transgjinorë përdoren për shfrytëzim seksual, për shembull nëpërmjet prostitucionit të detyruar[23].

Në kufi, çiftet joheteroseksuale dhe familjet e tyre përballen me rreziqe më të mëdha për t'u ndarë dhe ata mund të trajtohen pa marrë parasysh të drejtat e tyre. Kur ndalohen, migrantët LGBTIQ+ përballen me rreziqe më të larta izolimi, si dhe dhunë seksuale dhe me bazë gjinore nëse identiteti i tyre gjinor ose orientimi seksual zbulohet nga migrantë ose zyrtarë të tjerë. Shpesh, migrantët transgjinorë që ndalohen, grupohen me të burgosur që nuk kanë të njëjtën gjini me atë me të cilën identifikohen, gjë që i bën ata edhe më të rrezikuar nga dhuna.

Kur mbërrijnë në vendin e tyre të destinacionit, migrantët LGBTIQ+ kanë gjithashtu më shumë gjasa të punojnë në ekonominë informale dhe kanë rreziqe më të larta të papunësisë dhe varfërisë. Ata gjithashtu ka të ngjarë të përballen me rreziqe të ngjashme ose më të larta të dhunës, si dhe ksenofobisë, racizmit, mizogjinisë, diskriminimit ndaj moshës, marginalizimit socio-ekonomik dhe izolimit. Këto çështje shpesh nuk raportohen, edhe nuk duken në syrin e publikut.

Pavarësisht këtyre fakteve, ka një mungesë të madhe të qasjes me bazë gjinore në politikat e migracionit: fakti që migrimi është një përvojë gjinore, që burrat dhe gratë nuk përballen me të njëjtin rrezik kur janë në lëvizje, që njerëzit LGBTQ+ janë veçanërisht vulnerabël, nuk merret parasysh kur hartohen politikat e migracionit.

3.3 Të miturit dhe të rinjtë

13% e popullsisë totale migrante në vitin 2020 ishin emigrantë fëmijë (nën moshën 18 vjeç), dhe 11% e popullsisë totale migrante ishin emigrantë të rinj (midis moshës 15 dhe 24 vjeç). Në vitin 2022 në BE kishte 39,515 azilkërkues të mitur të pashoqëruar[24].

Fëmijët dhe të rinjtë migrantë përballen me rrezik më të madh të abuzimit, trafikimit dhe shfrytëzimit, veçanërisht kur udhëtojnë vetëm dhe përmes rrugëve jo të sigurta të migrimit.

Gjatë udhëtimit të tyre, fëmijët migrantë kanë më shumë gjasa t'i nënshtrohen trafikimit, ata mund të shiten dhe abuzohen fizikisht ose seksualisht dhe mund të rekrutohen para ose gjatë udhëtimit të tyre. Fëmijët gjithashtu mund të ndahen nga kujdestarët e tyre kryesorë, prindërit ose të afërmit e tyre, para ose gjatë udhëtimit. Më pas ata kthehen në të mitur të pashoqëruar.

Të miturit e pashoqëruar janë veçanërisht më të rrezikuar nga rreziqet e migracionit, për shkak të moshës së tyre të vogël dhe për shkak se janë të pashoqëruar. Në shumë vende, statusi i tyre si pjesë e një pakice mund të vihet në dyshim nga autoritetet. Është e vështirë për shumë njerëz në këtë proces të vërtetojnë se janë të mitur, veçanërisht pasi shpeshherë humbasin dokumentet e identifikimit gjatë udhëtimit të tyre. Megjithatë, është thelbësore që Shtetet të ofrojnë kujdes të veçantë për të miturit e pashoqëruar, veçanërisht pasi ata priren më shumë se të rriturit të vuajnë nga sëmundjet e shëndetit fizik ose mendor.

Të shoqëruar ose jo, fëmijët gjithashtu përballen me rreziqe më të larta lëndimi ose vdekjeje kur kalojnë kufijtë, kushte të mjerueshme higjienike dhe kushte të papërshtatshme për fëmijët në kampet e refugjatëve, procedura të gjata azili dhe madje dhe ndalohen kur marrin urdhrin për t'u kthyer në vendin ose origjinën e tyre.

Edhe kur lindin në Evropë, të rinjtë, prindërit e të cilëve janë emigrantë, kanë më shumë gjasa të kenë vështirësi në integrimin social dhe profesional, pasi shpesh kanë një sfond më të ulët socio-ekonomik, rrugë më të vështira arsimore dhe përballen me diskriminime.

3.4 Çështjet e shëndetit fizik dhe mendor pas migrimit

Njerëzit në mërgim mund të kenë sëmundje fizike ose paaftësi, si rezultat i ngjarjeve në vendin e tyre të origjinës, në rrugën e migrimit, apo edhe që nga lindja. Këto shqetësime shëndetësore fizike i bëjnë ata edhe më të prekshëm. Ndërsa autoritetet duhet të vlerësojnë shëndetin fizik të migrantëve, sipas rregulloreve të BE-së, dhe veçanërisht të azilkërkuesve në regjistrim, mbetet një mungesë e përgjithshme e aksesit në shërbimet shëndetësore për migrantët. Barrierat gjuhësore, dallimet kulturore dhe mungesa e aksesit në informacion dhe shërbime, si dhe diskriminimi, mund ta bëjnë më të vështirë për migrantët aksesin në shërbimet shëndetësore. Shumë migrantë paraqesin raste të sëmundjeve ngjitëse të patrajtuar, si tuberkulozi, hepatiti viral dhe HIV, që mund të çojnë në komplikime serioze apo edhe vdekje. Sidomos për gratë, ato mund të jenë infektuar me HIV, shpesh si rezultat i përdhunimit, në çdo kohë të rrugës së tyre të migrimit.

Sëmundjet kronike pa monitorim të vazhdueshëm (diabeti, lëndimet, mungesa e mjekimit...) janë gjithashtu shumë të shpeshta në mesin e migrantëve. Në vendin e destinacionit, politikat në lidhje me aksesin në kujdesin shëndetësor mund të jenë shumë të kufizuara, gjë që kufizon aksesin e migrantëve në kujdesin shëndetësor. Sistemet e kujdesit shëndetësor, si spitalet, gjithashtu mund të mbingarkohen dhe thjesht nuk kanë kapacitet për të trajtuar më shumë njerëz sesa janë ndërtuar: kur objektet e emigrantëve ndërtohen në qytete të vogla ose në ishuj të vegjël, kjo mund të bëhet një problem i madh dhe të detyrojë migrantët, shëndeti i të cilëve është në rrezik për të pritur me muaj përpara se të kontrolloheni nga një profesionist shëndetësor.

Për sa i përket shëndetit mendor, migrantët janë gjithashtu më të prekshëm ndaj psikotraumave. Ata shpesh përjetojnë situata të pafavorshme ose traumatike në vendet e tyre të origjinës, të tilla si luftëra, dhunë fizike dhe dhunë me bazë gjinore, veçanërisht gratë. Udhëtimi i migrimit në vetvete është një ngjarje jetësore veçanërisht intensive, shpesh do të thotë që një person të ikë pa plan, me shpresën për të rindërtuar jetën diku tjetër dhe gjatë këtij udhëtimi ai mund të ekspozohet ndaj formave të tjera të dhunës. Kur mbërrijnë në vendet e destinacionit, njerëzit në mërgim përballen sërisht me përvoja traumatike: paqëndrueshmëri administrative, kohë të gjata pritjeje, situata të pasigurta ekonomike dhe të strehimit, racizëm, mungesë të aftësive gjuhësore. Proçeset administrative nëpër të cilat kalojnë, dhe veçanërisht proçesi i azilit, mund t'i detyrojë ata të japin vazhdimisht detaje rreth përvojave traumatike që kanë pasur, gjë që në vetvete është proçes shumë traumatizues.

Në të vërtetë, mund të jetë shumë e vështirë për ta që t'i kujtojnë vetes përvojat e vështira që kanë kaluar dhe të merren në pyetje për këto përvoja. Është mizore mungesa e shërbimeve thelbësore për migrantët, duke përfshirë shërbimet sociale, kujdesin fizik dhe shërbimet e shëndetit mendor, veçanërisht për gratë e mbijetuara nga dhuna. Madje, mungon edukimi i profesionistëve shëndetësorë dhe socialë për t'i shoqëruar. Veçanërisht për gratë migrante, këto shqetësime të shëndetit mendor mund ta bëjnë më të komplikuar integrimin në vendin e destinacionit

Përfundime

Megjithëse rruga e migrimit është një rrugë shumë e rrezikshme dhe çon në trauma që i bën njerëzit në mërgim edhe më të prekshëm, mund të thuhet me siguri se sistemi aktual i migracionit europian nuk i merr parasysh këto dobësi të shëndetit mendor. Këto veçanërisht nuk merren parasysh gjatë procesit të azilit, gjë që në vetvete mund të çojë në ritraumatizimin. Ai pasqyron një tendencë të përgjithshme të qeverive, politikanëve, por edhe medias dhe shoqërisë në përgjithësi, për t'i konsideruar njerëzit në mërgim jo si njerëz, por si figura apo valë. Shpresojmë që advokimi ynë do të ndihmojë që njerëzit të vendosen të parët në nivel europian, si dhe për njerëzit në mërgim që hyjnë në Europë.

Vetëvlerësimi përfundimtar

https://docs.google.com/forms/d/17IGYSKZy232ABNBA_qSdAD5tULL2I4lLeNgVe2vYn1l/edit

Aktivitetet

Aktiviteti 1

Lidhni fjalët që lidhen me temën e migrimit me përkufizimet e tyre përkatëse



Tema	Migracioni; fjalori; ligj nderkombëtar
Titulli	Lidhni fjalët që lidhen me temën e migrimit me përkufizimet e tyre përkatëse
Qëllimi	• Marrja e njohurive mbi përkufizimet specifike ligjore të fjalëve që kanë të bëjnë me migracionin; • aftësia për të njohur keqpërdorimin e fjalëve të caktuara në media / shoqëri / politikë; • për të rritur sensin kritik të pjesëmarrësve në lidhje me përdorimin e fjalëve
Kohëzgjatja	Hapi 1: 5 minuta; Hapi 2: 20 minuta Hapi 3: 15 minuta; Gjithsej: 50 minuta

Përshkrimi

Hapi 1

Trajnerët vendosin fletët me fjalët që lidhen me migrimin dhe përkufizimet e tyre. Duhet të ketë një kolonë me fjalët dhe një kolonë me përkufizimet. Trajnerët nuk duhet t'i vendosin fjalët drejtpërdrejt pranë përkufizimeve. Për më tepër, fjalët që lidhen me të njëjtën zonë (për shembull refugjat / migrim, imigrim / emigracion) nuk duhet të vendosen pranë njëra-tjetrës.

Hapi 2

Trajneri i ndan pjesëmarrësit në disa grupe. Secili grup caktohet të qëndrojë në një tavolinë dhe ka për detyrë të bashkojë fjalët që lidhen me migrimin me përkufizimet e tyre përkatëse. Në mënyrë ideale, pjesëmarrësit në secilin grup duhet të kenë nivele të ndryshme njohurish mbi përkufizimet, në mënyrë që të diskutojnë së bashku për atë që mendojnë se është përkufizimi i duhur dhe të mësojnë nga njëri-tjetri.

Hapi 3

Pjesëmarrësit mbledhen të gjithë së bashku dhe për çdo fjalë trajneri i kërkon një personi në një tavolinë të ndryshme për të thënë se cili është përkufizimi. Duhet të ndiqet rendi i fjalëve më poshtë, për t'i kushtuar një vëmendje të veçantë dallimeve midis të huajit/refugjatit/migrantit,imigrantit/emigrantit,trafikimit të qenieve njerëzore/kontrabandës me njerëz, vizës/leje qëndrimi, pasi këto fjalë janë veçanërisht të keqpërdorura në media dhe shoqërinë në përgjithësi. Mund të ketë një diskutim të përkufizimeve nëse ato janë të paqarta për disa pjesëmarrës, ose nëse ka pasur debate midis grupeve të ndryshme gjatë hapi 2.

Duhet të përdoren përkufizimet e mëposhtme:

I huaj: Kushdo që nuk ka shtetësinë e shtetit ku jeton

Refugjat: Dikush i detyruar të largohet nga vendi i tij dhe të kërkojë siguri në një vend tjetër, i cili nuk është në gjendje të kthehet në vendin e tij sepse ka frikë nga persekutimi.

Migrant: Një person që largohet nga vendbanimi i tij ose i saj i zakonshëm, qoftë brenda një vendi ose përtej një kufiri ndërkombëtar, përkohësisht ose përgjithmonë.

Azilkërkues: Dikush që kërkon mbrojtje ndërkombëtare, kërkesa e të cilit për statusin e refugjatit ose një lloj tjetër mbrojtje tjetër nuk është shqyrtuar ende.

Imigrant: Një jo-rezident që mbërrin në një shtet me synimin për të qëndruar për një periudhë më shumë se një vit.

Emigrant: Një rezident që niset ose del nga një shtet që synon të qëndrojë jashtë vendit për një periudhë më të madhe se një vit.

Pa shtetësi: Një person që nuk konsiderohet si shtetas nga asnjë shtet.

I mitur i pashoqëruar: Një i mitur që është ndarë nga të afërmit e tyre dhe nuk ka përkujdesjen e një të rrituri që është përgjegjës për të.

Trafikimi i qenieve njerëzore: Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose marrja e njerëzve nëpërmjet forcës, mashtrimit ose hileve, me qëllim shfrytëzimin e tyre për përfitim.

Kontrabanda me njerëz: Lehtësimi i hyrjes së paligjshme të një personi në një shtet, për përfitime financiare ose të tjera materiale.

Personi migrant në një situatë të parregullt: Një person që lëviz përtej kufirit ndërkombëtar dhe nuk është i autorizuar ligjërisht për të hyrë ose për të qëndruar në një shtet.

Migrimi i brendshëm: Migrantët që lëvizin brenda kufijve të vendit të tyre, duke kërkuar një qëndrim të ri të përkohshëm ose të përhershëm.

Viza: Një dokument zyrtar që jep leje nga një autoritet i huaj që ju të hyni në një vend.

Leje qëndrimi: Çdo autorizim i lëshuar nga autoritetet e një shteti të BE-së që lejon një shtetas të një vendi të tretë të qëndrojë ligjërisht në territorin e tij.

Vendi i tranzitit: Vendi, i ndryshëm nga vendi i origjinës, nëpër të cilin kalon një migrant për të hyrë në vendin e destinacionit.

Vendi i destinacionit: Vendi që është destinacion për flukset migratore.

Vendi i origjinës: Vendi i kombësisë ose, për personat pa shtetësi, i ish-rezidencës së zakonshme.

Ndiqui udhëtimin e një vajze migrante

Tema	Migrimi; gjinia; vija e jetës
Titulli	Ndiqui udhëtimin e një vajze migrante
Qëllimi	Ndërgjegjësimi për vështirësitë dhe dilemat me të cilat përballen gratë dhe vajzat në rrugëtimin e tyre të migrimit; aftësia për të treguar empati ndaj njerëzve në mërgim dhe njerëzve me prejardhje migrimi; kundërshtimi i keqkuptimeve ose klisheve të zakonshme rreth migrimit; rritja e mendimit kritik të pjesëmarrësve
Kohëzgjatja	Hapi 1: 5 minuta; Hapi 2: 25 minuta Hapi 3: 20 minuta; Gjithsej: 90 minuta
Materiale	Tavolina (1 për grup), karrige, kompjuterë ose laptopë (një për grup)
Pjesëmarrësit	Të gjithë pjesëmarrësit, të ndarë në grupe të ndryshme

Përshkrim

Hapi 1

Pjesëmarrësit formojne grupe prej 5 personash

Hapi2

Pjesëmarrësit nisin lojën e krijuar nga Femmes Entraide & Autonomie. Loja mund të gjendet në frëngjisht ose në anglisht në faqen e internetit të FEA. Sipas dijeve të gjuhës angleze të pjesëmarrësve të ndryshëm, ai mund të përkthehet në gjuhën përkatëse dhe në atë rast mund të shpërndahet një letër me përkthimin. Ose, një anëtar i grupit mund t'ua përkthejë të tjerëve. Pjesëmarrësit luajnë veç e veç, por trajnerët duhet të qëndrojnë vigjilentë gjatë këtij hapi, pasi kjo lojë mund të jetë mjaft shqetësuese për disa njerëz, dhe veçanërisht ata me sfond migrimi, pasi i vendos pjesëmarrëset në këpucët e grave migrante.

Hapi3

Pjesëmarrësit mblidhen të gjithë së bashku dhe diskutojnë nëse e ndjejnë të nevojshme se çfarë mendojnë për lojërat, dhe cilat emocione kanë ndjerë. Një mënyrë e mirë për ta bërë këtë është të lini çdo pjesëmarrës të ndajë ndjenjat e tij me grupin nëse dëshiron, dhe t'i lini pjesëmarrësit e tjerë të reagojnë ndaj këtyre ndjenjave duke bërë pyetje. Pjesëmarrësit duhet të jenë të vetëdijshëm për emocionet e njëri-tjetrit dhe të përmbahen nga përdorimi i termave gjykues. Përsëri, trajnerët duhet të jenë të vetëdijshëm për gjendjen emocionale të pjesëmarrësve dhe t'i lejojnë ata të bëjnë një pushim nëse është e nevojshme.

Nëse pjesëmarrësit nuk dëshirojnë të ndajnë emocionet e tyre, ata gjithashtu mund të diskutojnë supozimet e mëposhtme :

- Migrimi është krejtësisht jashtë kontrollit
- Janë duke na zënë vendet e punës / janë barrë ekonomike
- Refugjatët zgjedhin të migrojnë
- Ata nuk kanë nevojë për ndihmë, ata kanë një smartphone
- Disa mjete mund të përdoren për të hedhur poshtë këto pohime:
- Migrimi është krejtësisht jashtë kontrollit: ideja e një “krize emigracioni” portretizohet shpesh në media. Megjithatë, nuk ka asnjë provë shkencore që vërteton se migrimi global po përshpejtohet: migrantët përfaqësojnë vetëm 3% të popullsisë ndërkombëtare dhe ky numër ka qenë i qëndrueshëm gjatë viteve. Gjithashtu, rreth 80-85% e refugjatëve mbeten në rajonin e tyre të origjinës, dhe kështu nuk lëvizin në Europë. Për më tepër, një shumicë dërrmuese e njerëzve që lëvizin nga Jugu në Veri e bëjnë këtë ligjërisht: 9 nga 10 persona nga Afrika u shpërngulën në Europë legalisht. Ka pasur një rritje të migrimit në Europë gjatë viteve, por të huajt mbeten një pakicë në popullsinë evropiane.
- Ata po na zënë vendet e punës / janë një barrë për ekonominë: punëtorët migrantë përbëjnë një pjesë të mirë të fuqisë punëtore të sotme në Europë. Në të vërtetë, migrantët përbënin 70% të rritjes së fuqisë punëtore në Europë gjatë 10 viteve të fundit. Ata gjithashtu plotësojnë vende pune që nuk merren nga europianët vendas, si në sektorët me rritje të shpejtë ashtu edhe në sektorët në rënie të ekonomisë. Për më tepër, ata kontribuojnë më shumë në taksa dhe kontribute sociale sesa marrin në përfitime. Ato gjithashtu kontribuojnë në inovacionin dhe rritjen ekonomike.
- Refugjatët zgjedhin të migrojnë: sipas përkufizimit, refugjatët detyrohen të migrojnë, për shkak të persekutimit, luftës ose dhunës. Ata nuk mund të kthehen në atdheun e tyre. Në përgjithësi, migrantët nuk zgjedhin të migrojnë, dhe shpesh do të preferonin të qëndronin në vendet e tyre të origjinës nëse situata (ekonomike, politike, klimatike) do të ishte më e mirë. Ata shpesh lënë gjithçka pas për të gjetur një jetë më të mirë, duke përfshirë shtëpitë, punën, familjet, miqtë, kulturën dhe gjuhën e tyre. Rruga e migrimit është shumë e rrezikshme dhe e dhunshme.
- Ata nuk kanë nevojë për ndihmë, ata kanë një smartphone: një smartphone ose një telefon është diçka thelbësore për t'u patur, për të qenë në gjendje të qëndruar në kontakt me të afërmit që qëndrojnë në vendin e origjinës, të përdorni internetin për t'u regjistruar në platformat administrative, për të aksesuar informacionin, për të kontaktuar OJQ-të dhe administratat... Përsa i përket ndihmës sociale, ata nuk marrin shumë: 210,80 euro në muaj për azilkërkuesit në Francë, për shembull, ndërsa asgjë për migrantët që nuk janë azilkërkues.

Referencat

1"Global Trends." UNHCR,
<https://www.unhcr.org/global-trends>.
Accessed 4 March 2024.

2"Key facts about recent trends in global migration." Pew Research Center, 16 December 2022, <https://www.pewresearch.org/short-reads/2022/12/16/key-facts-about-recent-trends-in-global-migration/>. Accessed 4 March 2024.

3"The truth about asylum." Refugee Council,
<https://www.refugeecouncil.org.uk/information/refugee-asylum-facts/the-truth-about-asylum/>. Accessed 4 March 2024.

4"Data | Missing Migrants Project." Missing Migrants Project,
<https://missingmigrants.iom.int/data>. Accessed 4 March 2024.

5"Statistics on migration to Europe - European Commission." European Commission, https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/promoting-our-european-way-life/statistics-migration-europe_en. Accessed 4 March 2024.

6"Infographic - Data on returns of irregular migrants." European Parliament, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2021/690518/EPRS_AT_A\(2021\)690518_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2021/690518/EPRS_AT_A(2021)690518_EN.pdf). Accessed 4 March 2024.

7"L'essentiel sur... les immigrés et les étrangers." Insee,
<https://www.insee.fr/fr/statistiques/3633212>. Accessed 6 March 2024.

8Pène, François, and Verdes, Juliette. "Le solde migratoire des pays de l'Union européenne - Touteleurope.eu." Toute l'Europe, 28 April 2022, <https://www.touteleurope.eu/societe/les-migrations-en-europe/>. Accessed 4 March 2024.

9"Statistics on migration to Europe - European Commission." European Commission, https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/promoting-our-european-way-life/statistics-migration-europe_en. Accessed 4 March 2024.

10"2022 Schengen Visa Statistics by Third Country - SchengenVisaInfo." Schengen Visa Statistics, <https://statistics.schengenvisa.info.com/2022-schengen-visa-statistics-by-third-country/>. Accessed 4 March 2024.

11"EU migration and asylum policy - Consilium." Consilium.europa.eu, 21 February 2024, <https://www.consilium.europa.eu/en/policies/eu-migration-policy/>. Accessed 4 March 2024.

12"Irregular migration and return - European Commission." Migration and Home Affairs, https://home-affairs.ec.europa.eu/policies/migration-and-asylum/irregular-migration-and-return_en. Accessed 4 March 2024.

13"Migrant smuggling - European Commission." Migration and Home Affairs, https://home-affairs.ec.europa.eu/policies/migration-and-asylum/irregular-migration-and-return/migrant-smuggling_en. Accessed 4 March 2024.

14"Frontex at Fault: European Border Force Complicit in 'Illegal' Pushbacks - bellingscat." Bellingscat, 23 October 2020, <https://www.bellingcat.com/news/2020/10/23/frontex-at-fault-european-border-force-complicit-in-illegal-pushbacks/>. Accessed 11 March 2024.

15"Frontex's assistance with illegal push-backs from Croatia." European Parliament, https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/E-9-2019-003554_EN.html. Accessed 11 March 2024.

16"L'essentiel sur... les immigrés et les étrangers." Insee, <https://www.insee.fr/fr/statistiques/3633212>. Accessed 4 March 2024.

17Fiche 1 Problématique de l'immigration, https://local.attac.org/13/laciotat/IMG/pdf/fiche_1_problematique_de_l_immigration-1.pdf. Accessed 4 March 2024.

18Tertrais, Bruno. "L'immigration transforme la France, mais son impact économique est limité." Institut Montaigne, 9 November 2021, <https://www.institutmontaigne.org/expressions/limmigration-transforme-la-france-mais-son-impact-economique-est-limite>. Accessed 4 March 2024.

19"Italy - Migrants & Refugees Section." Migrants and Refugees Section, <https://migrants-refugees.va/country-profile/italy/>. Accessed 4 March 2024.

20"Spain - Migrants & Refugees Section." Migrants and Refugees Section, <https://migrants-refugees.va/country-profile/spain/>. Accessed 4 March 2024.

21“Albania – Migrants & Refugees Section.” Migrants and Refugees Section, <https://migrants-refugees.va/country-profile/albania/>. Accessed 4 March 2024.

22Di Iasio, Valentina, and Jackline Wahba. “Asylum seekers in Europe: where do people go and why?” Economics Observatory, 21 September 2023, <https://www.economicsobservatory.com/asylum-seekers-in-europe-where-do-people-go-and-why>. Accessed 4 March 2024.

23“Forcibly displaced LGBT persons face major challenges in search of safe haven.” ohchr, 16 May 2022, <https://www.ohchr.org/en/statements/2022/05/forcibly-displaced-lgbt-persons-face-major-challenges-search-safe-haven>. Accessed 4 March 2024.

24“Child and young migrants data.” Migration Data Portal, 22 February 2024, <https://www.migrationdataportal.org/themes/child-and-young-migrants>. Accessed 4 March 2024.

Partnerët



Coordinator
FEMMES ENTRAIDE ET AUTONOMIE / France
www.feaasso.org



CESIE / Italy
cesie.org



People in Focus / Albania
peopleinfocus.org



SAVE A GIRL SAVE A GENERATION / Spain
www.saveagirlsaveageneration.org

Impressum

Ky botim është zhvilluar dhe publikuar në kuadër të projektit “Pivot. Të rinjtë promovojnë votën e informuar” (2023-1-FR02-KA220-YOU-000167160)

Koordinatori i Projektit: Femmes Entraide et Autonomie.

Partnerët e projektit: CESIE, People in Focus, Save a Girl Save a Generation

Dizajni: CESIE.

Botuar në qershor 2024. Financuar nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë megjithatë vetëm ato të autorit(ve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian.

Pivot



KA220-YOU – Cooperation partnerships in youth

Financuar nga Bashkimi European. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë të autorit(ve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit European dhe apo të "Agence du Service Civique- Agence Erasmus+ France Jeunesse & Sport". As Bashkimi European dhe as "Agence du Service Civique- Agence Erasmus+ France Jeunesse & Sport " nuk janë përgjegjëse për ato.

Numri i projektit : 2023-1-FR02-KA220-YOU-000167160



**Co-funded by
the European Union**